

KRYEBASHKIAKU MZIU

Angazhim në çdo cep të qytetit për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e ambientit



FAQE 6

INVESTIME

Nisin punimet në rrugën "Bytyçi" në lagjen Bathore 1



FAQE 8

DENONCIMI

Qeveria lë Kamzën pa stacion zjarrfikësesh



FAQE 4

MUAJI SHTATOR

Veprimtari të shumta të Pallatit të Kulturës Kamëz



FAQE 7



Gazetë e Bashkisë Kamëz

KAMZA

E përdyjavshme
Nr. 218 Tetor 2018
Çmimi 20 lekë
drmediakamez@gmail.com
www.kamza.gov.al

Intervistë e kryebashkiakut Xhelal Mziu në "Fax News"

QEVERIA PO BËN DISKRIMINIME, NUK KA FINANCUAR ASNJË NGA 140 PROJEKTET E BASHKISË KAMËZ

FAQE 2-3

Ndërtimi i rrugës "Kaci" në Babrru të Vjetër, investim i Bashkisë Kamëz me të ardhurat e veta

Faqe 8

Kryeson Kamza/ Shkon 29 mijë numri i familjeve që qeveria në 2018 hoqi nga ndihma ekonomike

Faqe 5

Kryebashkiaku Mziu: Unikale në Shqipëri, "Rilindja" i heq Kamzës, bashkisë së 6-të në vend, Zyrën e Punës

Faqe 6

Shqipëria me numrin më të lartë të kërkesave në botë për azil në BE, për 1000 banorë

Faqe 4



Kryebashkiaku Mziu priti në një takim pune përfaqësuesit e organizatës ndërkombëtare "Lëvizja Dehoniano Evropiane"

FAQE 4



NË BRENDËSI

Fillojnë punimet për ndërtimin e Rrugës së Zanave në lagjen 1 Bathore

FAQE 8

Kryebashkiaku Xhelal Mziu: Nuk mbajtën asnjë premtim nga 2013-a, Gjylameti ripremton nga Kamza se si do të bëhet Vora!

FAQE 7

Rritje e cilësisë së shërbimeve të Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz

FAQE 6

Raporti i OBSH: Shqipëria si Afrika, Iraku, Siria... për kequshqyerjen, nga të uritur deri tek obezë

FAQE 5

Dhuna në familje, takim në Bashkinë Kamëz në bashkëpunim me Qendrën "Të Drejtat e Njeriut në Demokraci"

FAQE 7



Kryebashkiaku Xhelal Mziu në "Fax News"

Qeveria po bën diskriminime, nuk ka financuar asnjë nga 140 projektet e Bashkisë

Kryetari i Bashkisë së Kamzës, z. Xhelal Mziu, ishte i ftuar në studion e televizionit "Fax News", ku ka folur rreth punës së tij dhe vështirësive të hasura gjatë mandatit që po kalon.

Kryebashkiaku Mziu ka hedhur akuza të forta në drejtim të qeverisë "Rama" lidhur me atë që e quajti diskriminim mes bashkive të majta dhe atyre të djathta. Kryetari i Bashkisë Kamzë tha se qeveria po bën diskriminime, ndërsa tha se nga 140 projekte të Bashkisë asnjë prej tyre nuk është financuar nga qeveria. Më tej, ai tha se, ndonëse pritej që të kishte një përqindje më të madhe fondi i akorduar për pushtetin vendor, krahasuar me vitet 2011-2012, ka pasur ulje. Sipas z. Mziu, ndonëse qeveria ka folur për rritje të autonomisë së pushtetit vendor, kjo nuk ka ndodhur, pasi sot ka më pak autonomi sesa ka pasur më parë. Më poshtë është intervista e plotë e kryebashkiakut Mziu.



Me mua në studio është bashkuar kryetari i Bashkisë së Kamzës, z. Xhelal Mziu. Mirë se erdhët!

Mirë se ju gjeta dhe faleminderit për ftesën të qenë në audiencën e këtij televizioni, i cili pavarësisht se ka një periudhë të shkurtër, është bërë shumë i shkueshëm për banorët e qytetit të Kamzës!

Ndërkohë, jemi 10 muaj para zgjedhjeve të ardhshme lokale. Keni bërë një bilanc, a i keni realizuar ju objektivat tuaj apo edhe premtimet në këtë Bashki?

Në fakt, nuk e mbaj mendjen shumë të zgjedhjet e ardhshme. Ajo çfarë unë kam preokupim, edhe për përvojën që kam që prej vitit 2007, të shfrytëzoj çdo lloj potenciali timin, por edhe të resurseve që ka institucioni Bashki, por edhe partneriteti, që të bëj maksimumin dhe kur unë e bëj këtë, nuk më impresionon aspak afati kohor i zgjedhjeve të ardhshme. Unë besoj që ato se çfarë ishin premtuar në vitin 2015 kur unë rimora mandatin pothuajse kanë gjetur zgjidhje, pavarësisht afatit kohor, që pas 9 muajsh është mbarimi i këtij mandati.

A mendoni se reforma territoriale i justifikoi pritshmëritë në rastin e Kamzës?

Reforma territoriale ishte një reformë e cila i reduktoi njësitë vendore, nga 373 njësi në 61. U bë një trumbetim i madh. Ato do të kishin kompetenca të jashtëzakonshme; që do të ishin më pranë qytetarëve; do të kishin më shumë mundësi për t'u ardhur në ndihmë në shërbime dhe në investime. Por, në fakt, nuk ka ndodhur. Ndodhi vetëm ndarja gjeografike. Jo vetëm që nuk janë shtuar kompetencat, përkundrazi, për shkak të kësaj ndarjeje territoriale, jo pak herë edhe kompetencat, edhe pse ishin ligjërish që duhet t'i ushtronte pushteti vendor, përsëri ato janë bartur nga qeveria nën petkun e reformës territoriale, duke krijuar jo pak herë vakume ligjore apo mosnxerrjen e akteve nënligjore për implementimin e saj. Pra, mund të themi që pavarësisht se po mbyllet një mandat me ndarjen e re territoriale, akoma kemi vakume ligjore. Nuk është marrë ajo se çfarë është premtuar, madje në këto katër vite është premtuar për delegim kompetencash, por jo vetëm që nuk kanë kaluar kompetencat, përkundrazi, kemi pasur një kosto shtesë financiare për bashkitë, çfarë do të thotë që nuk është shkuar drejt asaj çfarë trumbetohej as nga qeveria apo edhe nga faktorët ndërkombehtarë. Pritej që të kishte një përqindje më të madhe në raport me GDP-në pushteti vendor nga fondi i akorduar për pushtetin vendor, përkundrazi, kemi një rënie, nëse do ta krahasojmë me vitet 2011-2012 të qeverisë së mëparshme. Së dyti, fondi që i jepet Bashkisë nuk është se përdoret i gjithi nga pushteti vendor. Mbjaj mend në qeverinë "Berisha" maksimumi deri në 30% të buxhetit të pushtetit vendor kishte dorë qeveria që ta jepte në formën e granteve konkurruese. Por, në këto vite qeverisje rreth 48-50 apo deri në 52% e këtij buxheti e ka në dorë qeveria, çfarë do të thotë se është ulur pavarësia, është më pak autonom pushteti vendor, ka shumë në dorë qeveria. Pra, qeveria arrin pastaj të bëjë edhe

selektive politike, duke e rritur ndjeshëm hendekun midis qyteteve që drejtohen nga të djathtët dhe atyre që drejtohen nga të majtët.

Ju i keni përsëritur disa herë akuzat se nuk keni bashkëpunim me qeverinë, por në fakt, nëse ju duhet ta kërkonti këtë bashkëpunim, do ta përfitonin nëse e kërkonti? Në rastin tuaj, a ka pasur projekte, të cilat i keni paraqitur, për të cilat qeveria nuk ju ka ofruar fondet për t'i realizuar në Bashkinë e Kamzës?

Unë e nuk kam për natyrë për t'u qarë dhe mendohej që



gjithçka ta kërkoj te vetja, por nganjëherë jo gjithçka varet nga vetja. Në raport me qeverinë ne kemi qenë koherentë për t'i dërguar projekte. Sot që ne flasim në këtë studio, kam rreth 140 projekte që nga viti 2015 e deri më sot dhe projekte që kanë të bëjnë me ndërtime rrugësh, me ndërtime ujësjellësi, me ndërtime kanalizimesh, me ndërtime shkollash, kopshtesh, çerdhesh, tregut të qytetit apo rivitalizime të qendrës urbane në Kamzë apo në Babrru apo të tjera projekte të cilat janë vërtet shumë sociale, shumë sensitive për qytetarët; janë shumë të domosdoshme për zhvillimin e biznesit dhe asnjë nga këto projekte nuk ka gjetur zgjidhje. Jo se këto projekte nuk kanë qenë konkurruese, sepse dua t'ju them që Bashkia e Kamzës ka hartuar projekte dhe ka një staf shumë të kualifikuar të urbanistikës; projekte të cilat kanë gjetur zgjidhje edhe te donatorët më të mëdhenj sot në botë. Kemi përfituar projekte nga Banka Botërore për ndërtim shkollash, për ndërtim rrugësh, për studimin urbanistik, për sistemin e adresave. Kemi përfituar projekte shkollë nga Komisioni Evropian. Pra, do të thotë që e kanë pasur dhe e kanë kualitetin teknik këto projekte, aq më tepër edhe atë social, se mund të them që sot Bashkia e Kamzës ka më shumë sesa 140 mijë banorë, duke qenë Bashkia e gjashtë në Shqipëri, por është edhe qyteti me sipërfaqen më të vogël, çfarë do të thotë që për kilometër katror ne kemi numrin më të madh të banorëve, pra nëse ne bëjmë rrugë, akses i kësaj rrugë është shumë herë më i madh sesa mesatarja e gjithë Shqipërisë apo se pjesa tjetër e njësisë vendore. Pra, projektet tona kanë qenë dhe janë projekte

konkurruese edhe në aspektin teknik, por edhe në aspektin social, por nuk kanë gjetur zgjidhje dhe unë nuk gjej argument tjetër përveç atij politik. E keqja është se të gjitha këto projekte ne i kemi dërguar konform standardeve, nuk begenisin për të kthyer edhe një përgjigje negative.

Si i kanë argumentuar?

Nuk kthejnë përgjigje, sepse po të kthenin përgjigje, nuk do të gjenin argumentet e nevojshme dhe janë mjaftuar me pothuajse 80 apo 90% të rasteve për të mos kthyer përgjigje ose, edhe kur kanë kthyer përgjigje, kanë thënë në këtë përgjigje se nuk u pa e arsyeshme për të financuar, por ngelemi të hapur për financime të tjera. Kjo e ka cunuar shumë zhvillimin e qytetit, sepse është rritur shumë diskriminimi midis bashkive. P.sh., ne jemi në kufi me qytetin e

Tiranës, çfarë do të thotë që kemi një vijë ndarësve prej rreth 13 km dhe në qoftë se në njërin anë të lumit mesatarja e këtyre qytetarëve që përfitojnë nga fondet e qeverisë, po themi, është pesë herë apo gjashtë herë më shumë sesa një banor i Kamzës, atëherë është diçka që ndikon negativisht te mirëqenia e atyre qytetarëve. Nga statistikat që kemi bërë në këto katër vite, del që në 61 bashki, jemi bashkia e fundit për sa u përket granteve të marra nga qeveria. Mesatarja e përfituesve të qytetit të Kamzës nga buxheti i shtetit është më e vogla dhe besoj që kjo është e papranueshme dhe nuk janë vetëm grante që ne i kemi pasur pothuajse zero nga qeveria, po ka qenë edhe delegimi i kompetencave dhe funksioneve "të reja" që qeveria për tre apo katër vite trumbeton që i ka deleguar, por nuk ka ndodhur ky delegim i kompetencave. Mjafton t'ju përmend disa nga këto rastet e delegimit të kompetencave për të parë edhe një herë se sa diskriminuese është në raport me Bashkinë e Kamzës, po edhe me shumicën e bashkive të djathta. Po jap një argument: mbrojtja kundër zjarrit apo zjarrfikëset ishte një nga shtatë kompetencat që u delegua drejt pushtetit vendor dhe në Tiranë ishin gjithsej katër reparte zjarrfikëse. Njëra është në Kombin, njëra tek Inxhinieria e Ndërtimit, njëra në Kinostudio dhe tjetra ishte në Kodër-Kamzë, që mbulonte Bashkinë e Kamzës dhe sa ndodhi ndarja e kompetencave drejt pushtetit vendor, ajo zjarrfikëse i kaloi Tiranës dhe sot, nëse në qytetin e Kamzës, që ka më shumë sesa 140 mijë banorë, ndodh zjarri, duhet që të komunikojmë me Bashkinë e Tiranës për të sjellë zjarrfikëse për t'i ardhur në ndihmë. A është normale kjo?! Jo vetëm që nuk u bë atëherë me ndarjen e tyre, por në ligj u sanksionua që në vitin 2015 se të gjitha bashkitë, të cilat nuk kanë përfituar nga shpërndarja e mjeteve apo reparteve etj., do të ishin pjesë e financimit të qeverisë deri në vitin 2018 dhe që nga 2015-ta e deri më sot jo vetëm që nuk kemi reparat, kemi bërë projektin e reparitit të zjarrfikësve; kemi gjetur vendin e reparitit dhe e kemi dërguar, madje u planifikua në vitin 2017 nga Ministria e Brendshme dhe rialokua dhe nuk erdhi. Dhe sot, në Bashkinë e Kamzës nuk ka reparat zjarrfikësesh, nuk ka mjete zjarrfikëseje dhe nuk ka punonjës të zjarrfikësive, të cilët paguhen nga buxheti i shtetit siç operohet edhe në bashkitë e tjera.

Ndërkohë, fatura financiare për këto shërbime kujt i shkon?

Bashkia paguan, pra është një tjerë kosto shtesë, ndaj po them unë që është rritur fatura financiare. Po ju jap një argument tjetër: ka kaluar rrjeti i ujësjellësit dhe i vaditjes ose Bordi i Kullimit, që ishte ndërmarrje shtetërore atëherë me varësi nga pushteti qendror. U nda, nuk na u dha asnjë nga këto mjete që kishin ato dhe përkundrazi, edhe me vendim të Këshillit të Ministrave u bë blerja e 61 ekskavatorëve për 61 bashkitë dhe çudia ndodhi që Bashkia e Kamzës zero, Bashkia e Tiranës dy dhe të gjitha bashkitë e tjera nga një. Pra, është një diskriminim vërtet i jashtëzakonshëm. Vetëm në nëntorin e vitit që shkoi, për shkak edhe të mungesës së financimit nga qeveria në



lidhje me kolektorët, por edhe për shkak të mungesës së këtij ekskavatori, u përmytën më shumë sesa 700 familje, prej të cilave 200 apo më shumë ishin të pajetueshme më, pra krijoi një kosto të jashtëzakonshme. Kemi raste të tjera, kemi pyjet sot në territorin e Kamzës dhe zero lekë financim. Kemi më shumë 510 rrugë, të cilat janë të standardeve si të rrugëve të bashkive të tjera dhe jemi e vetmja bashki ku nuk delegohet financim për mirëmbajtjen e rrugëve. Unë e bëra gjithë këtë argument për të treguar edhe një herë diskriminimin që bëhet ndaj bashkive në përgjithësi të djathta, po sidomos ndaj Bashkisë së Kamzës. Pra, për të shkruar në referencë të pyetjes fillestare, për të treguar se si ka qenë reforma territoriale, sa ka dhënë impakte pozitive, unë them që nuk ka dhënë efekte pozitive, por përkundrazi, ka pasur më shumë dorë pushteti qendror dhe ka rritur hendekun midis financimeve të bashkive të djathta dhe atyre të majta.

Dua t'u referohem disa takimeve që ka organizuar Kryeministri Rama me kryebashkiakët e gjithë Shqipërisë. Disa herë, të paktën nga ajo që na është ofruar nga regjia e Kryeministrit, kemi parë se mungojnë kryebashkiakët e djathtë, madje edhe Kryeministri disa herë ka shprehur keqardhjen e mungesës suaj. Në rast të këtyre mungesave, ju e keni përjashtuar veten, duke mos marrë pjesë në takimet me qeverinë qendrore apo është rezultat i moskoordinimit për projektet e bashkive?

Që të jem i sinqertë, do të them që jo vetëm nga 2015-ta, por edhe nga 2013-ta unë kam marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga qeveria, pavarësisht bindjeve të kundërta politike, duke respektuar edhe pozicionin që unë kam, po edhe për shkak të atyre qytetarëve të cilët nuk kanë vetëm një ngjyrë, po janë nga të gjitha partitë politike. Pra, unë kam qenë i pranishëm në të gjitha tryezat që ka zhvilluar Kryeministri apo ministrat, por të gjitha ato takime që ka marrë pjesë edhe Kryeministri, kanë qenë fasadë, pavarësisht se jemi ftuar edhe në rrethe të ngushta, siç kanë qenë organizimet te

vite që nuk funksionon. Kjo shkollë do të ishte në kuadrin e emergjencës, që do të thotë nëse bllokohet një shkollë, duhet që të kthehet në gjendjen që ka qenë ose të ndërtohet shkollë e re. Pavarësisht se kemi dërguar projekt për prishjen dhe ndërtimin e një shkolle të re, sot e kësaj dite nuk është gjetur zgjidhja. Pra, jo vetëm që nuk është ndërtuar shkollë e re, por përkundrazi, kemi një shkollë më pak. Jo se s'kemi dërguar projekte, kemi dërguar projekte pafundësisht, projekte për ndërtimin e gjashtë apo shtatë shkollave të reja, që kemi gjetur edhe trojet, ndërtimin e kopshteve të reja, ristrukturimin e shkollave ekzistuese, ristrukturimin e kopshteve, por nuk kemi gjetur zgjidhjen e duhur. Kemi edhe një problem tjetër shqetësues, sidomos për arsimin parashkollor. Është vërtet shumë e dhimbshme, arsimi parashkollor është në standardet më të ulëta të Shqipërisë. Sot në kopshte shkojnë rreth 45% e fëmijëve dhe rreth 55% prej tyre nuk shkojnë në kopsht, për shumë arsye. Së pari, nuk shkojnë sepse mungojnë kopshtet nëpër lagjet e tyre. Bashkia ka tentuar, pavarësisht se jemi në vitin 2018, që të marrë objekte me qera që t'u vijmë në ndihmë këtyre banorëve, por ka një kapacitet edhe Bashkia dhe ka një kosto financiare, por megjithatë kemi marrë në 3-4 vende kopshte me qera e, megjithatë, jemi larg standardit. Pra, mungojnë objektet për kopshte dhe, së dyti, mungon edhe fondi i punonjëseve të arsimit parashkollor për këta fëmijë, sepse të paktën do ta kishim zvogëluar këtë të keqe, duke e tjetërsuar buxhetin e Bashkisë për të marrë të tjera objekte me qera, po është kufizuar edhe numri. Sipas numrit të nxënësve që duhet të ishin në Kamëz, ne duhet të kishim diku te 255 deri në 260 edukatorë kopshti dhe sot ne kemi rreth 120, pra kemi rreth 60% më pak. Ai është një fond i deleguar nga qeverisja qendrore dhe besoj që edhe ky është një problem shumë shqetësues, jo vetëm për sot, por edhe në perspektivë, sepse imagjino një fëmijë i cili nuk ka pasur mundësinë për të shkruar në kopsht dhe ai që ka në bankën e tij ka qenë tri vite në kopsht dhe ky s'ka qenë, se sa keq ndihet ky fëmijë apo familja e tij, që sheh një pabarazi tyre. Le të shërbejë ky rast si një apel



Kryeministria, dhe për çudi ndodh që fol e fol Kryeministri dhe pastaj sa mund të vijë rasti për të komunikuar kryetarët e bashkive, atij i del një punë dhe pastaj me kë të komunikojmë?! Me Endri Fugën apo me dikë tjetër?! Pra, nuk ka qenë mundësia edhe për të debatuar, jo vetëm që nuk u është kthyer përgjigje shkresave. Kjo ka shkruar deri aty sa në këto kohë e fundit, jo vetëm demokratët, po edhe një pjesë e kryetarëve të bashkive të majtë nuk kanë marrë pjesë, sepse është kthyer thjesht në një fasadë takimi që ka organizuar Kryeministri apo ministra të caktuar.

E qartë, ndërkohë ka pasur problematika arsimi këtë vit. Dua t'ju pyes: Çfarë ndodh në Kamëz? A ka një shkollë të re e cila është ndërtuar falë bashkëpunimit të Bashkisë me qeverinë?

Si kudo, Kamza, për shkak të informalitetit që e ka pasur - të mos harrojmë se Kamza ka qenë me 10 mijë banorë dhe këtë vit kishte 22-vjetorin e saj dhe sot ajo është 14-fishuar apo 15-fishuar, çfarë do të thotë që duke u kthyer nga një zonë e gjitha bujqësore dhe rurale për t'u kthyer në një zonë urbane - e vuan shumë këtë mungesën e infrastrukturës. Për sa i përket arsimit, mbaj mend në vitin 2007 kur unë kam shkruar aty, zhvillohej mësimi me tre turne, një klasë kishte 55-60 nxënës, një orë mësimi zhvillohej 15-20 minuta, pra ishte në kushte vërtet mizerabël. Por gjatë komunikimit që ne kishim me Kryeministrin Berisha në atë periudhë, u bë e mundur që ne të hartonim me dhjetëra projekte; të gjenim trojet për ndërtimin e këtyre projekteve dhe kemi përftuar vetëm në 6 vite 21 objekte shkollore. Në vitin 2013 dhe deri në ditën e sotme nuk është bërë asnjë objekt shkollor deri në këto momente, por përkundrazi kemi edhe një objekt shkollor më pak sesa para gjashtë vitesh, sepse ka qenë një shkollë, shkolla "Halit Coka" në qendër të Bathores, e cila kishte më shumë sesa 2500 nxënës. Për shkak të ekspertizës që kanë bërë specialistët inxhinierë, konsiderohet si një shkollë me risk të lartë, e cila mund të kthehet në një katastrofë për këta nxënës dhe ka dy

për Ministrinë e Arsimit minimalisht për të bërë delegimin e fondit të këtij personeli dhe pastaj për të pasur një sforcë edhe nga Bashkia për të gjetur objekte me qera deri në akordimin e fondit për ndërtimin e këtyre kopshteve.

Çfarë mund të thoni për qendrat shëndetësore? Si Bashkia e gjashtë në vend, a ka mjaftueshëm, a ka pasur qendra të reja shëndetësore, a ka problematika?

Kemi kërkuar ndërtimin e një spitali, sepse është absurde që një qytet i tillë të mos ketë një spital. Në mungesë të ndërtimit të një spitali të paktën të kishim qendra shëndetësore bashkëkohore. Deri në këto momente që flasim, në këto pesë vite është bërë vetëm ristrukturimi i një qendre shëndetësore në qendrën e Kamzës, në një godinë dykatëshe, dhe me aq është mjaftuar. Pavarësisht se kjo nuk është kompetencë e pushtetit vendor, është vërtet shumë e dhimbshme kur njerëzit detyrohen për të shkruar nga Kamza drejt spitaleve apo qendrave shëndetësore të Tiranës.

Ju folët për problemet me arsimin, për shëndetësinë, gjithashtu folët për një diskriminim të qytetarëve të Kamzës. Dua t'ju pyes se çfarë ka ndodhur me skemat e mbështetjes ekonomike apo të ndihmës financiare për familjet në nevojë. Ka pasur përjashtime?

Qyteti i Kamzës është i përbërë nga familje të cilat realisht kanë qenë në gjendje të mjerueshme dhe askush nuk e braktiste vendin e tij për të ardhur në Kamëz. Të gjithë ata që kanë ardhur, kanë ardhur për shkak të kushteve atmosferike, por sidomos edhe të atyre ekonomike, çfarë do të thotë që të gjitha ato familje që kanë ardhur në Kamëz, janë jo pak, por më shumë se 30 mijë familje të reja që kanë ardhur në Kamëz. Pothuajse 70-80% e tyre trajtoheshin me ndihmë ekonomike në zonat ku ato kanë qenë. Në vitin 2013, kanë qenë diku te 7200 familje në Kamëz e Paskuqan që trajtoheshin me ndihmë ekonomike dhe sot që ne flasim, kemi më pak sesa 500 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike. 500 familje



në 36 mijë familje, pra 1 në 72 familje që trajtohet me ndihmë ekonomike është vërtet një luks i jashtëzakonshëm dhe në këtë rast, po ngelem në rolin e denoncuesit, por në fakt ky është një realitet. Po të shkojmë në "Blok" dhe të shohim në 72 familje t'i kontrollojmë, jam i sigurt që 2, 3 apo 5 prej tyre do të trajtohen me ndihmë ekonomike. Po të shkosh në Kamëz, 1 në 72 familje trajtohet me ndihmë ekonomike. Çudia tjetër, hiqen padrejtësisht, pa argument, sepse ne kemi qenë në qarkun pilot, ku që para katër vitesh aplikojë online dhe me sistemin e pikëzimit përjashtoheshin ato që nuk plotësonin pikavarazhin e nevojshëm. Me futjen e pikëzimit në gjithë Shqipërinë bëri që nga diku te 3500 familje që trajtoheshin në Kamëz apo Paskuqan me ndihmë ekonomike, sot kemi rreth 500, pra 7 herë më pak. U përjashtuan pa argument. Akoma më tej, ka një tjetër argument qesharak. Zyra e Punës, ku shkojnë e marrin vërtetime që trajtohen me ndihmë ekonomike, ka qenë që nga viti '90, mos me thënë që në kohën e Enver Hoxhës, po të paktën që nga viti '90, ka qenë akomoduar pranë ish-komunës në atë periudhë dhe Bashkisë që nga viti '96 e në vazhdim dhe ka 4 vite kjo Zyrë Pune nuk rri si në asnjë vend tjetër të Shqipërisë, e akomoduar pranë institucionit Bashki, por e kanë lëvizur në mënyrë portative nëpër Kamëz, por ka shtatë muaj që qendra e Zyrës së Punës ku duhet të shkojnë ata të cilët janë në nevojë për ndihmë ekonomike, që s'kanë asnjë lloj mundësie për të lëvizur, e kanë marrë qendrën e Zyrës së Punës të Kamzës dhe e kanë sjellë në Tiranë. Është e pamundur për ta gjetur edhe unë si kryetar Bashkie se ku është e jo ku mund ta gjejë një qytetar që mezi pret që të marrë ndihmën ekonomike, që varion nga 15 mijë lekë të vjetra deri në 50 mijë lekë të vjetra, që me atë mund të blejë ilaçe apo thesin e miellit dhe jo të shkojë e të shpenzojë pafundësisht për të ardhur që atje dhe deri këtu dhe pastaj kanë gjetur pretekste artificiale, sepse, meqenëse nuk ka ardhur familja apo nuk kanë ardhur të gjithë pjesëtarët e familjes, i kanë hequr nga skema e ndihmës ekonomike. Pra, ngelet vërtet një plagë e rëndë për banorët e asaj zone, të cilët padrejtësisht nuk përfitojnë ndihmën ekonomike.

Vjen një pyetje nga Facebook-u: Paskuqani ka qenë komunë, tani është në juridiksionin e Bashkisë së Kamzës. A ka plane të zhvillimit?

Po, Kamza dhe Paskuqani kanë pasur planin urbanistik sipas ligjit të ri të vitit 2009 dhe në dhjetor të vitit 2012 Kamza ka pasur urbanistik, madje bashkë me Beratin kanë qenë dy bashkitë e para që kanë bërë planin e ri urbanistik. Pastaj edhe Paskuqani në pranverën e vitit 2013. Por, me ndarjen e re territoriale që ka ndodhur, sot Kamza nuk ka plan të ri urbanistik. Nga 61 bashkitë që kanë bërë planin urbanistik, 47 prej tyre kanë bërë planin urbanistik dhe 15 prej tyre kanë ngelur pa plan urbanistik. Nga këto 47, 5 janë financuar nga USAID-i, 5 janë financuar nga Ambasada Zvicerane dhe 37 të tjera, janë bërë në tri vite, janë bërë nga qeveria shqiptare. Është po prapë e papranueshme që një qytet nëse kishte nevojë për një plan të ri, unifikim të planit urbanistik do të ishte Kamza, sepse kishte dy plane që vetëm thjesht të bëhej harmonizimi i tyre, pra kërkonte një kosto shumë herë më të ulët dhe duke qenë një zonë informale dhe në zhvillim të shpejtë, për të parandaluar ndërtimet pa leje etj., etj., kishte nevojë për të pasur një plan urbanistik. Sot e kësaj dite nuk e kemi këtë plan urbanistik. Jemi bashkë me disa bashki të tjera në të cilat askush s'kërkon leje ndërtimi. Bie fjala, janë ca bashki, të cilat kanë 3 apo 5 mijë banorë dhe një qytet me 140 mijë banorë nuk ka plan të ri urbanistik dhe kjo ka ndrydhur zhvillimin e biznesit për ndërtimin e pallateve, për ndërtimin e fabrikave apo të tjera, të cilët jo pak herë janë detyruar për të dalë jashtë territorit të Bashkisë për të zhvilluar biznesin e tyre.

Z. Mziu, për ta mbyllur, a do të kandidoni më për ta drejtuar Bashkinë e Kamzës?

Unë, siç e thashë në fillimin e bisedës, jam i fokusuar për të bërë maksimumin deri ditën e fundit që unë i shërbej institucionit të Bashkisë. Ngelem i prirur për ta vazhduar dhe më tej për të bërë maksimumin për qytetin tim, Kamza.

Zoti Mziu, faleminderit për këtë bisedë!

Kënaqësi komunikimi me ju dhe mundësia që më dhatë për të shpalosur disa nga problematikat që ka qyteti ynë!



Kryebashkiaku Mziu priti në një takim pune përfaqësuesit e organizatës ndërkombëtare “Lëvizja Dehoniano Evropiane”

Kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në zyrën e tij përfaqësuesit e organizatës “Lëvizja Dehoniano Evropiane”. Në këtë takim u hodhën idetë e bashkëpunimit për mbështetjen me projekte konkrete për zgjerimin e rrjetit të punësimit të banorëve të Kamzës. Ky takim konkretizoi edhe një herë vëmendjen e veçantë që z. Mziu ka për politikën e zhvillimit të qytetit. “Punësimi, - theksoi kryebashkiaku Mziu, - mbetet një nga hallkat më të dobëta që ka qyteti i 5-të në Shqipëri për vetë politikën diskriminuese që po përdor qeveria qendrore ndaj këtyre qytetarëve. Edhe pse ka një luftë politike të vazhdueshme, ne kemi promovuar politika të bazuar në strategji konkrete për të mundësuar punësimin, sidomos të rinjve e të rejave dhe grupeve me indeks të theksuar social, siç janë femrat kryefamiljare, por edhe ato që nuk kanë një mundësi punësimi në sektorin privat”.

Përfaqësuesit e kësaj organizate, presidentja e saj, znj. Gema Carretero Pardo, si dhe drejtori i Qendrës Studimore të kësaj organizate, dr. Carlo Scippacercola, e shtrinë diskutimin e këtij bashkëpunimi, i cili me shumë gjasë do të jetë afatgjatë për projektet konkrete që ata kanë, duke gjetur një ambient mjaft të favorshëm për implementimin e tyre.



Projekti i parë është ai i investimit në fushën e ndërtimit të serrave me aktivitet bujqësor, duke u dhënë mundësi punësimi mjaft familjeve në nevojë.

Ky projekt krijon jo vetëm mundësinë e punësimit, sigurimin e të ardhurave për familjarët, por zbeh edhe varësinë e këtyre familjeve nga mbështetja në skemën e ndihmës ekonomike, prej së cilës çdo ditë qeveria qendrore largon dhjetëra e dhjetëra familje.



“Rritja e papunësisë dhe varfërimi i qytetarëve të Kamzës ka vënë para përfaqësuesit të gjithë autoritetin e Bashkisë Kamëz për të gjetur burime dhe rrugë alternative për të mundësuar përmirësimin e situatës së punësimit dhe njëkohësisht edhe përmirësimin jetësor. Prandaj e konsideroj shumë vlerë këtë hap të parë bashkëpunues me këtë organizatë për të hapur një dritare të re plot shpresë për qytetarët e Kamzës”, - theksoi në fjalën e tij përmblylës kryebashkiaku Mziu.

Xhelal Mziu: Qeveria lë Kamzën pa stacion zjarrfikësesh, automjete dhe personel, në rast nevojë duhet t'i drejtohet Tiranës!

Diskriminimi ndaj Kamzës i qeverisë së “Rilindjes” nuk njeh kufij. Veç mungesës së investimeve në Kamzë, mosfinancimit të mbi 135 projekteve të Bashkisë çuar ministrive të linjës (ku flenë në sirtarët e tyre), mosofritim të granteve, Bashkia nuk i kanë kaluar as kompetencat bazuar në ndarjen e re territoriale shoqëruar kjo edhe me faturren financiare dhe personelin.

Në kuadër të denoncimeve rast pas rasti, kryebashkiaku Xhelal Mziu denoncon faktin që Kamza, Bashkia e 6-të në vend, nuk ka një stacion zjarrfikësesh, nuk ka asnjë automjet dhe personel të duhur dhe qeveria prej vitit 2015 nuk i ka kaluar asnjë fond Bashkisë me qëllim blerjen e automjeteve të reja.

“Situata është e paprecedentë, për faktin se në rast zjarri apo dhe përmbajtjes Kamza nuk ka asnjë automjet zjarrfikës dhe rrjedhimisht as stacion zjarrfikësesh, duke mos pasur mjete dhe personel të duhur. Me kalimin e kompetencave duhej që Kamzës t'i kalonte një stacion zjarrfikësesh.

Kemi 4 reparte zjarrfikësesh: në Kombin, tek Inxhinieria e Ndërtimit, Kinostudio dhe në Kodër-Kamëz pranë UBT-së dhe asnjëri prej stacioneve s'i ka kaluar Kamzës. E sanksionuar edhe në ligjin e 2015-ës është që kush s'ka përfutur nga kjo



ndarje qeveria të na sillte mjetet ose fondin që t'i blinin vetë. Madje, ne bëmë gati edhe projektin dhe planifikuan edhe vendin në vitin 2017 në komunikim me Ministrinë e Brendshme, por fondi u rialokua dhe nuk na erdhi. As automjete dhe as fonde nuk na kanë kaluar dhe sot në rast të një zjarri apo përmbajtjeje, Bashkia Kamëz duhet t'i kërkojë ndihmë Tiranës.

A nuk është kjo absurde!? Çfarë mund të quhet tjetër veçse diskriminim i pastër për qëllime politike”, - thotë kryebashkiaku Xhelal Mziu.

Kreu i Bashkisë Kamëz thotë së pavarësisht kërkesave apo edhe premtimit të Kryeministrit në takimin që pati në Kamzë, asgjë nuk është bërë. “Dua të theksoj faktin se në mbledhjen më të fundit të Këshillit të Ministrave, qeveria vendosi një fond prej 50 milionë lekësh të reja për blerje automjeteve zjarrfikëse për bashkitë dhe Kamza sërish rezultoi e diskriminuar”, - thotë kryetari i Bashkisë së Kamzës, Xhelal Mziu.


Kryebashkiaku Xhelal Mziu në mënyrë sistematike i ka përmendur rastet diskriminuese, si: largimin nga skema e ndihmës ekonomike të mbi 6 mijë familjeve, heqjen e Zyrës së Punës nga qyteti, mosfinancimin për ndërtimin e shkollave të reja dhe rikonstruksionin e atyre që u ndërtuan nga qeverisja e PD-së, mosplotësimin e personelit të kopshteve dhe shkollave si pasojë e fondit që nuk ofrohet nga MASR, moskalimin e konviktit të shkollës “Lori Boriçi” nën administrim të Bashkisë Kamëz, që aktualisht dhe çuditërisht administrohet nga Bashkia Tiranë.

Shqipëria me numrin më të lartë të kërkesave në botë për azil në BE, për 1000 banorë

Edhe pse jetojnë në një vend që ka nisur rrugën e pakthyeshme drejt anëtarësimin në BE dhe nuk ka konflikte të brendshme apo luftëra, shqiptarët duan të largohen më shumë se çdo shtet tjetër në botë. Në 12 muajt e fundit shqiptarët kanë shënuar numrin më të lartë të azilkërkuësve për herë të parë në raport me popullsinë, duke lënë pas edhe popujt që po largohen nga lufta. Bazuar në të dhënat që ka publikuar Eurostat mbi numrin e aplikimeve të reja në 12 muajt e fundit, popullsinë sipas Bankës Botërore dhe llogaritjeve të “Monitorit”, për çdo 1000 banorë shqiptarë, 6.5 prej tyre kanë aplikuar për azil në Bashkimin Evropian. Në vend të dytë, pas Shqipërisë, për numër të lartë aplikimesh për 1000 banorë renditet Siria me 4.7 aplikime gjatë 12 muajve të fundit, nga ku azilkërkuësit largohen prej luftës drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Të tretët renditen gjeorgjianët, ku numri i aplikimeve për azil në 12 muajt e fundit llogaritet 3.9, pasuar nga Eritrea, ku numri i azilkërkuësve për herë të parë është 3.6 për 1000 banorë. Iraku dhe Palestina, vende që kanë gjithashtu një numër të lartë azilkërkuësish, për 1000 Banorë kanë shënuar përkatësisht 1.2 dhe 1.1 aplikime. Kryesisht në 30 vendet me numrin më të lartë të aplikuesve bëjnë pjesë shtetet që janë në luftë dhe konflikte, disa vende afrikane dhe shtete që aktualisht po përballen me kriza të forta ekonomike, si Venezuela dhe Turqia. Ndërsa për sa i përket numrit në vlerë absolute të azilkërkuësve për herë të parë në Bashkimin

Evropian, nga Shqipëria janë regjistruar në vetëm 12 muajt e fundit 18,620 aplikime, duke u renditur të shtatit nga 30 vendet e origjinës që kanë numrin më të lartë të azilkërkuësve. Në vend të parë qëndron Siria me mbi 86 mijë aplikime, Iraku me mbi 43 mijë, Afganistani me mbi 36 mijë, Nigeria mbi 29 mijë, Pakistani mbi 25 mijë dhe Eritrea me mbi 19 mijë. Megjithatë, duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë së këtyre shteteve, numri i aplikimeve nga Shqipëria mbetet shqetësues, edhe pse fluksi i aplikimeve për azil ka ardhur në rënie, pasi kulmoi në 2015-n, me mbi 60 mijë aplikimeve, ka zbritur në një mesatare prej rreth 16-20 mijë aplikime në vit.

Në 6-mujorin e parë 8040 aplikime/ Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2018, numri në total i aplikimeve për herë të parë nga shqiptarët për azil llogaritet 8040. Sipas statistikave të Eurostat në tremujorin e dytë të 2018-s në të gjithë Bashkimin Evropian u regjistruan 136,700 azilkërkuës për herë të parë. Krahasuar me një tremujor më parë, numri i azilkërkuësve në BE u rrit me 4%. Në T1 të këtij viti aplikuan për azil rreth 131,400 azilkërkuës. Pjesa më e madhe e aplikimeve janë regjistruar në Gjermani, Francë dhe Greqi. Ndërsa Eurostat raporton se afërsisht 1 milion aplikimi për azil janë ende në pritje. Shqipëria vijon të jetë shteti evropian me numrin më të lartë të azilkërkuësve në BE. Sipas statistikave që ka publikuar Eurostat, në tremujorin e dytë të vitit 2018 aplikuan për herë të parë për azil 3930 persona, apo 3% e totalit të azil kërkuësve



në Bashkimin Evropian. Franca, destinacioni i preferuar i azilantëve shqiptarë/ Franca rezultoi të jetë vendi me numrin më të lartë të azilkërkuësve edhe për tremujorin e dytë të 2018-s, me 38% të kërkesave, apo rreth 1495 aplikues. Në vend të dytë për numër të lartë aplikuesish, ndryshe nga tremujorët e kaluar renditet Greqia, me rreth 20% të kërkesave për azil apo 800 aplikues. Ndërsa në vend të tretë është Mbretëria e Bashkuar, ku vetëm gjatë tremujorit të dytë kanë aplikuar për azil rreth 500 shqiptarë apo 13% e totalit./ Monitor/



Kryeson Kamza/Shkon 29 mijë numri i familjeve që qeveria në 2018 hoqi nga ndihma ekonomike

Tetor 2018
GAZETA KAMZA

5




Pseudoreforma në ndihmën ekonomike ka bërë që numri i familjeve të nxjerra nga skema, nga muaji shkurt 2018 deri më tani, të shkojë në 29 mijë familje në të gjithë vendin, sipas të dhënave të fundit të INSTAT. Kamza mbetet rekordi i familjeve të përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike, rrjedhimisht

politikisht nga skema e ndihmës ekonomike në Kamzë. Nga të dhënat në shkallë vendi shihet se mbi 35% e familjeve që më parë trajtoheshin me ndihmë, tani nuk e marrin më. Mirëpo teksa numri i familjeve është shkurtuar me ritme të larta, masa e ndihmës për familje

familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike po shkon drejt përgjysmimit, pagesa për ndihmën ekonomike është 35 për qind më e ulët se kufiri ndërkombëtar i minimumit jetik dhe 68 për qind më i ulët se vlerësimet kombëtare. Edhe pse familjet e larguara padrejtësisht nga ndihma ekonomike, duke

Kamza, më e diskriminuara e qeverisë, mbi 6500 është numri i familjeve, që hiqen padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike



Burimi: INSTAT

më e diskriminuara e qeverisë së "Rilindjes". Ky diskriminim politik dhe krahnor që u bëhet banorëve të Bashkisë Kamzë është i paprecedentë, i patolerueshëm si dhe mizor. Kjo, për faktin se ka shkuar mbi 6500, numri i familjeve të larguara padrejtësisht dhe

ose nuk ka lëvizur ose ka shënuar një rritje krejt të papërfillshme. Kësti mujor i ndihmës ekonomike është shumë më i ulët se minimumi jetik. Aktualisht sipas standardeve ndërkombëtare të varfërisë minimumi jetik është 2 dollarë në ditë. Edhe pse numri i

iu mohuar kafshatën, ishin përjashtuar me pa të drejtë, dhe se kriteret e përdorura nuk ishin tregues realë të situatës, kjo nuk ka zgjidhur asgjë deri më tani! Bashkitë i kanë përcjellë ankesat e qytetarëve pranë, e cila është edhe përgjegjësja për projektin. Por

nga ajo kohë duket se edhe vetë institucionet kanë konstatuar se numri i familjeve të varfra është realisht edhe më i madh, ndërsa Ministria e Mbrojtjes Sociale dhe qeveria nuk kanë bërë asgjë.

Shqipëria, shpenzimet më të ulëta në Evropë për arsimin nga buxheti i shtetit, do të ulen sërish 3 vitet e fundit

Arsimi në Shqipëri vazhdon të mos ketë vëmendjen e duhur të qeverisë shqiptare dhe kjo jo vetëm konstatohet nga vetë qytetarët, por edhe nga ndërkombëtarët. Vitin e kaluar, sektori i arsimit u financua në 3.1% të PBB sikurse dhe këtë vit. Mirëpo nga të dhënat e detajuara nga Ministria e Arsimit mësohet se 1% e PBB, nga 3.1%, financohet nga pagesat e familjarëve nëpërmjet tarifave direkte. Përqindja e financimit të familjarëve u rrit dukshëm pas rritjes së tarifave në arsimin e lartë pas vitit 2015 (tarifat që paguajnë familjarët derdhen në buxhetin e Ministrisë së Arsimit, që më pas i rishpërndan për nevojat e veta). Sipas një analize të fundit të United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO) Shqipëria vijon të ketë financim të ulët për arsimin në raport me PBB në raport me vendet e tjera të kontinentit. Në Shqipëri, shpenzimet e qeverisë për arsimin kanë qenë të ulëta dhe gjatë viteve të fundit. Në mënyrë krahasimore, në lidhje me shpenzimet në arsim si përqindje e PBB-së, treguesi i Shqipërisë është



poshtë vendeve të rajonit që financojnë 4-5% të PBB për arsimin dhe poshtë vendeve të OECD që financojnë 6-7 % të PBB-së tyre për arsimin. Financimi i pamjaftueshëm i

arsimit ndikon negativisht në cilësinë e shkollimit, sidomos shtresat e pavaforizuara të popullsisë. Në vend që hendeku i financimeve në arsim të plotësohet, qeveria ka planifikuar të kundërtën, fondet do të ulen më tej gjatë tre viteve në vijim. Sipas planifikimit afatmesëm të Ministrisë së Financave, shpenzimet për arsimin nga 3.1-3.3% e PBB-së më 2018-2019 do të zbrasin në 3% në 2020 dhe 2021. Shqipëria u rendit e fundit në rajon për shpenzimet dedikuara arsimit gjatë vitit të kaluar. Shqipëria shpenzoi 3.1 për qind të PBB-së për arsimin teksa vendet e tjera të rajonit ky tregues është në intervalin 4-4.5% të PBB-së. Infrastruktura e sektorit të arsimit në Shqipëri mbetet shumë e dobët dhe nuk po bëhet para për zhvillime në sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në nivel kombëtar, teksa modeli arsimor vijon të jetë nën presionin e politikave afatshkurtra, ku kurrikulat ndryshojnë vazhdimisht me ndryshimin e ministrave.

Raporti i OBSH: Shqipëria si Afrika, Iraku, Siria... për kequshqyerjen, nga të uritur deri tek obezë


Raporti i BB/ Zhvillim i mangët fizik i fëmijëve meshkuj nga kequshqyerja, Shqipëria ndër vendet më numrin më të lartë në botë

Studime të reja vijnë të sinjalizojnë se numri i njerëzve të uritur në botë po rritet. Sipas raportit të Sigurisë Ushqimore dhe të Ushqyerit në Botë 2018, Shqipëria rezulton ndër të paktat vende në botë që vuan nga forma të shumfishta të kequshqyerjes, që nis nga kequshqimi në moshë të hershme, uria në një pjesë të konsiderueshme të popullatës (sidomos moshat e vogla), obeziteti të fëmijëve dhe tek të rriturit. Grupi i shteteve me kaq shumë llojshmëri problematikash në të ushqyer përfshin edhe Egjiptin, Libinë, Sirinë, Irakun, Afrikën e Jugut dhe vendi ynë krahas tyre. Raporti thekson se uria ka qenë në rritje gjatë tri viteve të fundit, duke u kthyer në nivele prej një dekade më parë.

Ana tjetër e urisë: obeziteti në rritje/ Shëndoshja e të rriturve po përkeqësohet dhe më shumë se një në tetë të rritur në botë është i shëndoshë dhe obez. Problemi është më i rëndësishëm në Amerikën e Veriut, por Afrika dhe Azia gjithashtu po përjetojnë një prirje rritëse, tregon raporti. Pakënaqësia dhe mbipeshja bashkëjetojnë në shumë vende dhe madje mund të shihen krahas për krahas në të njëjtën "shtëpi". Qasja e dobët në ushqimin kalorik, për shkak të kostos së saj më të lartë, stresi i jetesës me pasigurinë e ushqimit dhe përshtatjet fiziologjike



të privimit ushqimor ndihmojnë në shpjegimin e arsyeve pse familjet mund të kenë një rrezik më të lartë të mbipeshës dhe të trashje. Ndërkohë, Shqipëria ka prevalencë të lartë të fëmijëve që kanë zhvillim të mangët fizik, sidomos në peshë dhe në gjatësi në grupin e vendeve me të ardhura të mesme të larta, sipas një raporti të Bankës Botërore të publikuar së fundmi mbi Indikatorët e Zhvillimit të Qëndrueshëm Global.





Kryebashkiaku Xhelal Mziu: Angazhim në çdo cep të qytetit për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e ambientit

Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka kërkuar angazhim në çdo cep të qytetit për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e ambientit. Kështu, Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit është strukturuar në organizimin e punës për të mbrojtur dhe mirëmbajtur në çdo cep mjedisin në territorin e Bashkisë Kamëz.

Këto ditë ka vijuar puna e specifikuar në rrugën "Dajti" në Njësinë Administrative Bathore. Ka pasur një zhvendosje të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave me organizime ditore dhe për koherencë me një transport të makinave me karroceri pas mbledhjes dhe grumbullimit të qytetarëve të kësaj zone të vendosura në qese të zeza plasmasi.

Kjo u bë e mundur si rezultat i një këshille të vazhdueshme me anë të së cilës kryebashkiaku Xhelal Mziu ka kërkuar nga strukturat drejtuese



të kësaj ndërmarrjeje shërbimi, vendosjen e kontejnerëve të rinj edhe në këtë segment rrugor, që do të shërbejë edhe si një pikë grumbullimi të mbetjeve organike me selektim për diferencimin dhe më pas riciklimin e këtyre.

Kjo politikë shërbimi si dhe sociale u lind për t'u zbatuar edhe në këtë lagje që kufizohet me argjinaturën e lumit Tërkuzë.

Ngarkesa me mbetje të ndryshme bëri që Bashkia të merrte menjëherë masat për të neutralizuar ndotjet e ajrit edhe për banorët e kësaj lagjeje, në zbatim të nismës së kryebashkiakut Mziu për të pasur angazhim në çdo cep të territorit të Bashkisë Kamëz për të shtuar përgjegjshmërinë për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e ambientit.

Kryebashkiaku Mziu: Unikale në Shqipëri, "Rilindja" i heq Kamzës, bashkisë së 6-të në vend, Zyrën e Punës

Absurdi i "Rilindjes" nuk ka të sosur. Mirë që prej vitit 2013 nuk kanë punësuar qytetarët, por institucionet që janë përgjegjëse për nxitjen e punësimit kanë qenë totalisht ineficente.

Kujtojmë propagandën e qeverisë për hapjen e zyrave të punës, rikonstruksionin e tyre, duke harxhuar paratë e taksapaguesve shqiptarë për komoditetin e të punësuarve të "Rilindjes" apo trajnimeve të pasuksesshme, por pas 5 vitesh në pushtet zyrat kanë rezultuar pa efektivitetin e duhur. Pavarësisht nga kjo, qeveria e "Rilindjes" ka bërë atë që nuk pritej, duke mos i shtuar këto zyra në shërbimin qytetar, por edhe duke i hequr aty ku ishin.

Rasti konkret është Kamza. Kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu, e ka dënuar që në momentin kur ndodhi, pra u mor vendimi për ta lënë Kamzën pa Zyrë Pune dhe sërish reagon ndaj këtij absurdi.

"Jemi rast unikale në Shqipëri, në të 61 bashkitë, që Kamza nuk ka Zyrë Pune. Qeveria e ka hequr Zyrën e Punës nga njësi jonë administrative për ta çuar në territorin e Bashkisë Tiranë.

Ky është një absurditet, e pafalshme. Si mund të lësh bashkinë e 6-të më të madhe në vend për nga numri i popullsisë pa Zyrën e Punës!?"

Banorëve të Kamzës u duhet të shkojnë në Tiranë duke harxhuar kohë dhe para, duke ndenjur në radhë për një vërtetim papunësie apo kërkesë për t'u punësuar!," -

thotë kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu. Sipas kryebashkiakut Mziu, kjo vijë sjelljeje e qeverisë me këtë veprim konkret është në vazhden e diskriminimit që qeveria "Rama" po i bën Kamzës dhe banorëve të saj prej ditës së parë që "Rilindja" erdhi në pushtet në vitin 2013. Zyra e Punës në Kamëz duhet të kthehet urgjent, jo se ka pasur efektivitetin e duhur për të punësuar qytetarët, duke qenë ineficente si të gjitha zyrat e tjera, por është e nevojshme për procedurat e nevojshme administrative që u duhen banorëve të Kamzës të kryejnë në këtë zyrë të shtetit.

Bashkia Kamëz i pati ofruar ambientet te One Stop Shop-i për Zyrën e Punës, ashtu siç kanë qenë dikur, më pas "Rilindja" e transferoi në një ambient privat, derisa erdhi momenti kur e hoqën fare nga Kamza këtë zyrë.

Në një studim të posaçëm për efektivitetin e zyrave të punësimit në Shqipëri, Banka Botërore ka gjetur mungesë efçencë në zyrat e punës sidomos në drejtim të ndërmjetësimit.

Në këtë studim BB konstaton se "Shërbimi i Kombëtar i Punësimit në Shqipëri, përveçse ndërmjetëson punëdhënësit dhe punëmarrësit, ofron trajnim për të papunët e regjistruar, por efektiviteti i këtyre trajnimeve është në diskutim për shkak se pas përfundimit punësohen shumë pak ose aspak persona".



Zyra e Punës në ambiente private



Fluks i ndjeshëm pune në One Stop Shop

Gjatë kësaj periudhe ka pasur një fluks qytetarësh si edhe nga nxënësit e shkollave të arsimit parauniversitar për marrjen e shërbimeve të duhura në sportelet e One Stop Shop-it. Ky intensifikim i kërkesave ndaj shërbimeve në sportelet e One Stop Shop-it është një vlerësim për sa u përket të gjitha shërbimeve që Bashkia Kamëz u ofron qytetarëve të saj. Është një moment ku po kërkohet në vijimësi nga kryebashkiaku Xhelal Mziu që të gjitha strukturat e Bashkisë të jenë në standardet e duhura për të ofruar shërbimet e duhura. Ky shërbim ka vijuar edhe në njësitë e tjera administrative, si në Bathore dhe Paskuqan, duke u ruajtur i njëjti nivel dhe në respekt të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore me të cilat operojnë zyrat e shërbimit. Shërbimi që u është ofruar qytetarëve të Bashkisë Kamëz ka qenë mjaft korrekt dhe është realizuar në kohën e duhur. Kjo do të jetë motoja e shërbimeve jo vetëm në sportelet e One Stop Shop-it, por në të gjitha zyrat. Kjo është kërkuar në vijimësi nga kryebashkiaku Mziu nga e gjithë administrata e Bashkisë Kamëz.

Rritje e cilësisë së shërbimeve të Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz



Cilësia e shërbimeve të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Kamëz ka ardhur gjithnjë në rritje.

Për të ofruar më të mirën për qytetarët, strukturat e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve kanë pasur angazhim maksimal për shërbimin e furnizimit me

ujë ndaj qytetarëve. Duke qenë një shërbim jetik për banorët, puna nga punonjësit e ndërmarrjes nuk ka orar, pasi çdo ditë të javës ata janë në terren për ofrimin e shërbimit sa më korrekt.

Duhet filluar nga çdo punonjës i kësaj ndërmarrjeje, që nga stacioni i pompimit

të ujit, te manovratorët, faturistët, ekipi i hidraulikëve dhe të gjitha strukturat janë në terren për ofrim shërbimi.

Disa prej punëve të rëndësishme, me të cilat janë marrë këto struktura gjatë kësaj periudhe, është vendosja e matësve, leximi i tyre, si dhe pastrimi i pusëve të komandimit për të qenë më korrektë ndaj shërbimit qytetar.

Investimet në çdo lagje të qytetit dhe ofrimi i shërbimeve sa më cilësore për qytetarët janë kryefjala e punës së Bashkisë Kamëz, njëkohësisht edhe vizioni dhe premtimi i mbajtur i kryebashkiakut Xhelal Mziu.



Performancë financiare efiçente e Bashkisë Kamëz, kryebashkiaku Xhelal Mziu e ka vënë buxhetin në shërbim të qytetarëve

“Rilindja”, përfaqësuesit e saj në Parlament dhe qeveri jo vetëm që në 6 vjet e kanë harruar Kamzën, duke mos i financuar asnjë projekt, por edhe kur bëjnë takim me të vetët nuk dinë se ku janë. Herë thonë në Kamëz dhe pastaj e mbyllin duke përshëndetur banorët e Vorës. Kjo ndodhi në takimin e Asamblesë së PS-së Kamëz, ku duket qartë mosserioziteti dhe mungesa e vëmendjes së kësaj qeverie ndaj Kamzës dhe banorëve të saj. Ishte Blerina Gjylameti, kryetarja e PS Tiranë, - e shoqëruar nga Taulanti i “Toyota Yaris”-it dhe deputeti që ka provuar humbjen dërmuese në Kamëz Rakip Suli, - e cila nisi të fliste për arritjet imagjinare të “Rilindjes” në Kamëz për ta mbyllur me premtimin që i tillë ka mbetur prej ditës që kanë ardhur në pushtet për të bërë më shumë për “Vorën” që duan. Pra, duket qartë se këta zyrtarë rilindas kishin ardhur në Kamëz për xhiron e radhës të bindur në dështimin po të radhës që i pret. I kujtojmë Blerinës, Taulantit dhe Rakipit se më kot mundohen të bëjnë propagandë në Kamëz, pasi veprimet konkrete të kësaj qeverie si dhe mosveprimet, kur është dashur, e kanë diskriminuar Kamzën dhe banorët e saj.

Me këtë rast u kujtojmë atyre dhe shefit të tyre Edi Rama faktet konkrete se si e kanë diskriminuar Kamzën, duke mos iu përgjigjur nevojave të saj. Asnjë status në Facebook, as takimet me të vetët, madje as ndjesa nuk vlen që ata të kenë sy dhe faqe



të dalin para banorëve dhe premtojnë paturpësisht përsëri. I është kërkuar qeverisë të financojë ndërtimin e 6 shkollave, 7 kopshteve, si dhe financimin e rikonstruksionit të 9 shkollave dhe mbi 6 kopshteve, por asnjë financim nuk ka ardhur nga kjo qeveri.

Në fakt, jo vetëm që nuk kanë bërë shumë, por nuk kanë bërë as pak, sepse Kamza nuk ka përfutur asnjë financim në asnjë fushë: as në arsim, as në shëndetësi, as në infrastrukturë

dhe as nuk është rritur numri i të punësuarve. E kundërta ka ndodhur në këto gjashtë vite: rritje e papunësisë, madje edhe një zyrë pune që ishte në Kamëz e hoqën jo vetëm nga sportelet e One Stop Shop-it në Bashki, por edhe nga qyteti. Janë varfëruar familjet e Kamzës deri në ekstrem, janë bërë arrestime dhe burgosje për fatura të energjisë elektrike, për ndërtime pa leje dhe për tjegullat e çative etj. Edi Rama vetëm është tallur me Kamzën dhe qytetarët e saj, pasi ka rikonstruktuar vetëm një qendër shëndetësore, për të cilën Bashkia Kamëz ka të gatshëm projektin për ndërtimin e një të reje, me të gjitha standardet bashkëkohore, por që nuk financohet nga qeveria, ashtu siç janë lënë të harruar mbi 135 projekte me të cilat kjo Bashki ka aplikuar për gjashtë vite.

Ka pasur mungesë totale të investimeve në arsim, në një kohë kur Bashkia dhe qeveria e Partisë Demokratike për gjashtë vjet ndërtoi 18 shkolla të reja. Nga ana tjetër, për sa i përket infrastrukturës, Bashkia Kamëz ka ndërtuar me qindra kilometra rrugë me të ardhurat e veta, duke qenë se qeveria diskriminuese nuk ia ka haberin as se ku ndodhet Kamza dhe këtë e vërteton edhe znj. Gjylameti.

Në këtë mënyrë vijon nëpërkëmbja dhe diskriminimi nga qeveria i qytetarëve të Kamzës. Kamza nuk e ka pasur asnjë moment vëmendjen e qeverisë, por mashtrimin e tyre duan ta shesin përsëri, me propagandë, ashtu si në 2013-ën vetë Kryeministri mashtrues e diskriminues.

Veprimtari të shumta të Pallatit të Kulturës Kamëz gjatë muajit shtator



Muaji shtator u karakterizua nga një mori veprimtarish të Pallatit të Kulturës Kamëz. Kështu, nën kujdesin e kryebashkiakut Xhelal Mziu, Pallati i Kulturës Kamëz mori pjesë në festivalin “Jehona e Vendlindjes” në Drenas të Kosovës, me instrumentistë dhe këngëtarë të vegjël të ansambllit “Kaltërsia”. Një përfaqësim dinjitoz dhe i merituar, që meritoi duartrokitjet e publikut. Ndërkaq, juria vlerësoi si këngëtaresh më të mirë këngëtareshen e këtij ansambli Aishe Sallahi. Ndërsa më 28 shtator u zhvillua ceremonia e promovimit të librit kushtuar dëshmorit të UÇK-së Halit Coka, të autorit Esat Bytyçi, ku i pranishëm ishte edhe kryebashkiaku Xhelal Mziu. Libri përmban të gjithë historinë e veprimtarisë së jetës së dëshmorit Hali Coka deri në rënien e tij heroike për çështje kombëtare, por jashtë kufijve të Shqipërisë. Një tjetër veprimtari e suksesshme ishte edhe koncerti me pjesëmarrjen e grupit folklorik të shoqatës “Afërdita”, Tiranë, i cili u shoqërua me këngë dhe valle të ndryshme.



Dhuna në familje, takim në Bashkinë Kamëz në bashkëpunim me Qendrën “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”

Në sallën e Këshillit Bashkiak të Kamzës u zhvillua një takim në bashkëpunim me Qendrën “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit “Për riaktivizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” (ose ndryshe - Mekanizmi referues) që ka si objekt kryesor mbështetjen e funksionimit të mekanizmit të referimit në Bashkinë e Kamzës, me qëllim menaxhimin në mënyrë të koordinuar të rasteve të dhunës kundër grave dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për gratë/vajzat. Në këtë takim, u raportua se gjatë periudhës kohore shtator janë trajtuar 8 raste të dhunës në familje. Për këto raste janë ofruar disa shërbime nga Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”: konsulencë dhe asistencë ligjore, vlerësim social-ekonomik, referime te Zyra e Punës, referime te Zyra Arsimore, ndihma në pako ushqimore nga bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe fondacionit Olive for Charity dhe ALSAR, libra falas për fëmijët, mundësi punësimi etj.



Ndërtimi i rrugës "Kaci" në Babrru të Vjetër, investim i Bashkisë Kamëz me të ardhurat e veta

Pas lirimit të hapësirave ka nisur zbatimimi i projektit të rrugës "Kaci" në Babrru të Vjetër, investim i Bashkisë Kamëz me të ardhurat e veta.

Duke qenë se Njësia Administrative e Paskuqanit kishte mungesa në infrastrukturën urbane, Bashkia Kamëz është përpjekur që me të gjitha mundësitë dhe burimet e saj financiare të përmirësojë gjendjen e trashëguar. Ky ka qenë edhe premtimi i kryebashkiakut Xhelal Mziu, urbanizimi i Paskuqanit në të gjitha lagjet e tij. Duhet thënë se që nga fillimi i vitit 2016 e deri tani numërohen me dhjetëra projekte të realizuara në këtë njësi, rrugë, kanalizime, mes të cilave spikat ndërtimi i bulevardit "Demokracia" me gjatësi 7 km, i cili u lehtëson lëvizjen jo vetëm qytetarëve të Paskuqanit, por edhe të gjithë atyre që zgjedhin të kalojnë në këtë segment të rëndësishëm rrugor. Një tjetër investim madhor i Bashkisë Kamëz është edhe



rikualifikimi urban i qendrës në Babrru. Projekti për ndërtimin e rrugës "Kaci" është fryt i punës së specialistëve të Urbanistikës në Bashkinë Kamëz, pas kërkesave të banorëve të zonës. Realizimi i këtij projekti u vjen në ndihmë mijëra banorëve të zonës, duke bërë që të ketë një impakt tejet pozitiv realizimi i këtij investimi, që ka një gjatësi prej 705 metrash linearë dhe gjerësi 5 metra.

Nisin punimet në rrugën "Bytyçi" në lagjen Bathore 1



Kanë nisur punimet për ndërtimin e rrugës "Bytyçi" në lagjen Bathore 1. Ky është investimi i radhës, i cili nën vëmendjen e veçantë të kryebashkiakut Xhelal Mziu, po bëhet realitet, duke u ardhur në ndihmë qytetarëve të lagjes 1 Bathore. Pas përfundimit të procedurave të tenderimit ka nisur kështu puna për ndërtimin e rrugës "Bytyçi", e cila financohet nga të ardhurat e buxhetit të Bashkisë. Segmenti ku po investohet kap një gjatësi prej 190 m dhe një gjerësi asfaltimi prej 5 metrash dhe gjerësi bankine në të dy krahët e rrugës nga 0.5 m. Këta parametra të investimit krijojnë për banorët përfitues të rrugës "Bytyçi" në lagjen Bathore 1 një rehabilitim të plotë të infrastrukturës rrugore dhe për rrjedhojë një përmirësim të dukshëm të mjedisit përreth. Impakti do të ndihet i thellë për të gjithë kalimtarët si dhe mjetet që do të përshkojnë këtë segment. Ky investim i planifikuar për këtë vit bën që Bashkia Kamëz dhe veçanërisht kryebashkiaku Mziu të vazhdojnë të realizojnë premtimet dhe angazhimet për qytetarët dhe qytetin e Kamzës.

Fillojnë punimet për ndërtimin e Rrugës së Zanave në lagjen 1 Bathore



Pas lirimit të hapësirave publike, fillojnë punimet edhe për ndërtimin e Rrugës së Zanave në lagjen 1 Bathore. Pasi kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe pas lirimit të hapësirave nisin kështu punimet edhe në këtë investim themelor të Bashkisë Kamëz për vitin 2018.

Duke qenë se qeveria e majtë nuk ka financuar asnjë projekt të Bashkisë, duke i diskriminuar vazhdimisht qytetarët e Kamzës, kryebashkiaku Xhelal Mziu ka zgjedhur t'u qëndrojnë sa më pranë halleve të qytetarëve në zgjidhjen e menjëhershme të çdo problematike dhe krijimin e një infrastrukture moderne

për çdo qytetar të Kamzës. Dhe një nga investimet më të rëndësishme është edhe Rrugja e Zanave, me gjatësi 1480 metra linearë dhe gjerësi 16 m. Ashtu si të gjitha investimet edhe ky investim shumë i rëndësishëm dhe themelor realizohet nga fondet e Bashkisë. Investimi do të ketë një infrastrukturë të ndërthurur me përmbajtje të të gjitha elementeve të nevojshme bashkëkohore.

Kjo shihet edhe te komponentë të tillë si gjerësia 16 m, trotualet në të dyja anët e rrugës me gjerësi 4 m, si dhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura. Përfitues të këtij investimi do të jenë jo vetëm qindra familje të lagjes Bathore 1, por edhe qytetarë të lagjeve të tjera të zonës, që kalojnë në këtë segment rrugor. Ndërtimi i këtij segmenti rrugor shumë të rëndësishëm do të ndikojë edhe në zhvillimin e klimës së biznesit të këtyre qytetarëve përfitues të një investimi themelor të Bashkisë Kamëz.

Gjithashtu, është shumë i nevojshëm ndërtimi i kësaj rruge pasi rruga aktuale ashtë në gjendje jo të përshtatshme për lëvizjen e këmbësorëve.

Rrugët "Veli Dedi" dhe "Xhorxhi Martini" në Fushë-Kërçik, tjetër investim me ndikim të madh social



Kanë nisur punimet në rrugët "Veli Dedi" dhe "Xhorxhi Martini" në Fushë-Kërçik. Midis zonave ku kryebashkiaku Xhelal Mziu dhe Bashkia Kamëz kanë investuar dhe do të investojnë edhe në të ardhmen është lagja Fushë-Kërçik në Njësine Administrative të Paskuqanit, ku po zbatohet projekti i ndërtimit të rrugës "Veli Dedi" dhe "Xhorxhi Martini", me gjatësi 828 metra dhe gjerësi 7 metra. Ky projekt bën pjesë në strategjinë e zhvillimeve infrastrukturale në Bashkinë Kamëz. Me një gjatësi të konsiderueshme, ky investim bën

të mundur lidhjen e mijëra familjeve të zonës me rrugën kryesore të Paskuqanit, bulevardi "Demokracia", duke qenë kështu pjesë e një rrjeti të rëndësishëm rrugor. Projekti financohet me të ardhurat e Bashkisë, meqenëse qeveria për pesë vite diskriminon qytetarët e Kamzës, duke mos akorduar asnjë financim për ta. Gjatë kësaj periudhe ka filluar lirimi i hapësirave për realizimin e dhjetëra projekteve të reja të Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Një prej tyre është edhe ndërtimi i rrugëve "Veli Dedi" dhe "Xhorxhi Martini" në Fushë-Kërçik. Viti 2018 për Bashkinë Kamëz shënon vijimësinë e investimeve themelore e të rëndësishme. Të parashikuara nga buxheti i Bashkisë, këto investime përmirësojnë kryesisht infrastrukturën rrugore, të kanalizimeve, të arsimit etj. Përveç kësaj, e rëndësishme është se këto investime prekin çdo lagje të qytetit, duke përmirësuar ndjeshëm gjendjen e rrugëve, kanalizimeve, të objekteve të sistemit arsimor si kopshte dhe shkolla.

Ndërtimi i rrugës "Prengaj", projekti i radhës i Bashkisë Kamëz në Njësine Administrative të Paskuqanit



Ka nisur puna për realizimin e investimit në rrugën "Prengaj" në Fushë-Kërçik. Pas lirimit të hapësirave për këtë investim, tashmë ka filluar zbatimimi në terren i projektit të radhës të Bashkisë Kamëz në Njësine Administrative të Paskuqanit. Vëmendja e kryebashkiakut Xhelal Mziu ka qenë maksimale për ndërtimin e një infrastrukture urbane të plotë, me standarde bashkëkohore, në të gjitha lagjet e qytetit. Edhe rruga "Prengaj" bën pjesë në dhjetëra projekte që po realizohen gjatë këtij viti në gjithë territorin e qytetit të Kamzës. Investimi në rrugën "Prengaj" ka një gjatësi prej 686 metrash linearë, me gjerësi 7 metra, gjerësi asfalti 4.5 metra, me kanalizime të ujërave të bardha dhe me bankina. Këto elemente të përfshira në përbërjen e investimit sjellin një impakt infrastrukturor, si dhe një përmirësim ambientit të menjëhershëm për të gjithë banorët që preken nga investimi. Investimi i rrugës "Prengaj" është financim 100% i buxhetit të Bashkisë Kamëz, e cila vazhdon të ndjekë një politikë të kthimit të taksave dhe tatimeve në pjesën dërmuese të tyre në këtë destinacion. Kryebashkiaku Xhelal Mziu po bën realitet të gjitha premtimet e bëra për ndryshimin e menjëhershëm të gjendjes infrastrukturale në gjithë territorin e Bashkisë Kamëz.